



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Përgjithshëm**



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr.**                      **Prot.**  
**Nr. Dok. 201700361/2**

**Tiranë** \_\_\_/\_\_\_/2017

**Lënda:**            *Rekomandojmë marrjen e masave për rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruara për fëmijët në nevojë në Shtëpinë e Fëmijës "Zyber Hallulli", Tiranë.*

**Drejtuar:**            **Znj. Merita Xhafaj**  
**Drejtoreshë e Përgjithshme**  
**Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

**Znj. Etleva BISHA**  
**Drejtoreshë e Përgjithshme**  
**Shërbimi Social Shtetëror**

**Znj. Irma Shtini**  
**Drejtoreshë e institucionit**  
**Shtëpia e Fëmijës "Zyber Hallulli"**

**TIRANË**

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, në zbatim të urdhrit të Avokatit të Popullit nr. 51, datë 03.04.2017, kreu inspektimin e përgjithshëm në Shtëpinë e Fëmijës, "Zyber Hallulli", Tiranë më datë 10.04.2017. Avokati i Popullit pasi shqyrtojë informacionin nga monitorimi i realizuar, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë konkluzionet përfundimtare.

**Objektivat e inspektimit:**

- Vlersimi i dokumentacionit, procedurave dhe personelit në zbatim të legjisllacionit në fuqi.
- Respektimi i të drejtave të të fëmijëve në zbatim të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

**Metodologjia**

Grupi inspektues i institucionit të Avokatit të Popullit, i përbërë nga një juriste dhe një punonjës social, si metodologji pune ka përdorur:

- Zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e këtyre institucioneve, informacion i cili është hedhur në një formular standard për inspektimet e këtyre institucioneve.

- Kontrollin e 3 dosjeve në mënyrë rastësore të përfituesëve të institucionit.
- Kontrollin e dokumentacionit për organizimin dhe funksionimin e institucionit.
- Kryerjen e intervistave në grup me fëmijët me qëllim krijimin e një perceptimi sa më të plotë të trajtimit të tyre në këtë qendër.
- Inspektimin në vend të kushteve materiale në të cilat jetonin fëmijët, ambientet e përbashkëta, dhomat e gjumit, tualetet, dushet, pajisjet e hotelerisë, veshmbathjet, ushqimin, kuzhinën, lavanterinë, higjienën, lagështirën, bombolat kundër zjarrit, ambientet e jashtme të këtyre institucioneve etj.

Në përfundim të inspektimit, grupi monitorues i Institucionit të Avokatit të Popullit ka kryer bisedën përmblylëse me drejtuesin e institucionit dhe stafin në shërbim të drejtëpërdrejtë me fëmijët, ku u adresuan problematikat e evidentuara gjatë inspektimit ku u lanë edhe rekomandimet përkatëse, të cilat gjenden të detajuar në fund të raportit.

## **SHTËPIA E FËMIJËS “ZYBER HALLULLI”**

**Tipologjia:** Shërbim rezidencial, shtëpi-familje për fëmijët e braktisur dhe në nevojë. Institucioni është në administrimin e Shërbimit Social Shtetëror

**Drejtuesi:** Znj.Irma Shtini  
0695343731

**Adresa:** Rruga e Elbasanit , përballë Ambasadës Amerikane, Tiranë

**Nr i stafit:** 36 punonjës

**Nr i përfituesve:** **30 përfitues**

### **Shërbimet që ofrohen në këtë qendër janë:**

- Plotësimi i nevojave bazë ushqim, strehim ,veshmbathje
- Plotësimi i nevojave shëndetsore
- Shërbime psiko-sociale
- Terapi grupi dhe pune okupacionale
- Pjesmarrje në aktivitete kulturore

### **Administrimi, funksionimi dhe organizimi i Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë**

Shtëpia e Fëmijës Tiranë, “Zyber Hallulli”, është lincësuar nga QKB me **Nr LN 8585102014 dhe NIPT K 56700532S. lincense** për ofrimin e shërbime të përkujdesit social rezidenciale për fëmijët në nevojë. Adresa e institucionin e vendosur në lincense nuk korespondon me adresen reale të Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli”, Tiranë.

Grupmosha e fëmijëve që marrin shërbim rezidencial në këtë institucion është përcaktuar në zbatim të Udhëzimit Nr. 6, datë 21.5.2014 “*Për procedurat e sistemimit të fëmijëve në institucionet rezidenciale të përkujdesit shoqëror, publike dhe jopublik*” në momentin e inspektimit. Avokati i Popullit lidhur me caktimin e grupmoshës së fëmijëve që do të marrin shërbim në këtë institucion konstatoi se gjatë monitorimit stafi kishte filluar punën për zbatimin e *Vendimit Nr. 106 datë 15.02.2017 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 425 datë 27.06.2012 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve dhe*

*dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucione rezidenciale, publike dhe jo-publike të përkujdesjes shoqërore institucionit”*

Hartimi i akteve nënligjore për një periudhë shumë të shkurtër kohore tregon se rëndësia e ofrimit të shërbimeve të përkujdesit social për fëmijët në nevojë është fokusuar më shumë në organizimin e institucioneve sipas grupmoshave e cila sjell lëvizjen e vazhdueshme të fëmijëve, prishjen e marrëdhënieve të tyre me stafin, ndarjen e fëmijëve nga motrat dhe vëllezërit biologjik (sepse kanë mbushur moshën për t’u transferuar në një institucion tjetër) veprime të cilat bien ndesh me interesin më të lartë të fëmijës të përcaktuar në pikën 3, të nenit 6, të ligjit Nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Institucioni është nën varësinë administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, Ministri të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, në kundërshtim me pikën 1, të nenit 24, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ku thuhet se Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: *“Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj”*.

Organizimi dhe funksionimi i Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” është në zbatim të rregullore së miratuar, së bashku me urdhëresat përkatëse nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. Rregullorja e institucionit në përmbajtje është e përgjithshme për të gjitha institucionet e përkujdesit social rezidenciale për fëmijët të grupmoshës 6-18 vjeç. Kjo rregullore nuk është specifike për Shtëpinë e Fëmijës “Zyber Hallulli” ku të përcaktohen qartë objektivat, aktivitetet dhe shërbimet vetëm për këtë institucion.

Vendosja e misionit, vizioni dhe objektivave të përgjithshëm për të gjitha institucionet e përkujdesit social rezidencial të ndara sipas grupmoshave dhe mungesa e profilizimi specifik për çdo institucion të përkujdesit sociale të përfshirë në brëndësi të rregullores nuk krijon mundësinë e matjes së indikatorëve për realizimin e tyre. Konkretisht, transformimi i shërbimit rezidencial në Shtëpinë e fëmijës “Zyber Hallulli” ka filluar me krijimin e ambienteve të përshtatshme për ofrimin e shërbimit sipas modelit shtëpi-familje e pa pasqyruar konkretisht në këtë dokument dhe çfarë duhet të parashikohet për ta përqsur këtë shërbim në të ardhmen.

Organizimi i shërbimit rezidencial në institucion është në vendosjen e fëmijëve të ndarë sipas grupmoshave 6-10 vjeç; 11-14 vjeç; 14-16 vjeç dhe 16-18 vjeç në katër apartamenteve (shtëpi-familje) e paparashikuar në rregullore, vendim i rëndësishëm për zhvillimin normal të fëmijës.

### **Stafi i institucionit**

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit, organika përbëhet gjithësej nga 36 punonjës. Përkatësisht ishin drejtori, përgjegjësi i sektorit social me 23 veta si sektor; sektori i administratës me 12 veta staf. Sektori social mbulohej nga dy punonjëse sociale, nga të cilat njëra ishte përgjegjësjë e këtij sektori dhe dy psikologe (njëra nga programi intersheep i MMSR), një mjek, një kryekujdestare, 11 kujdestare, 6 edukatore, 1 përgjegjëse sektorit financiare, një magazinierë, 3 kuzhinierë, 5 sanitare, një roje, një mirëmbajtës.

Detyrat dhe përgjegjësite e stafit sipas pozicioneve të punës janë të parashikuara në rregulloren e brendshme të cilat kufizojnë organizimin e stafit për të përmbushur shërbimin e ofruar në këtë institucion sipas modelit shtëpi-familje. Aktivitet/element shumë i rëndësishëm, pjesë e rregullores është trajnimi në vazhdimësi i stafit ku duhet të konkretizohet në një aneks të veçantë me planifikimin e plani vjetor të trajnimeve të stafit.

### **Kushtet materiale**

Në zbatim të procesit të deinstitutionalizimit dhe objektivave të caktura në rregulloren e brendshme të institucionit për transformimin e shërbimit rezidencial në shërbime komunitare ambiente të këtij institucioni dhe janë strukturuar brenda të njëjtës ndërtesë në 4 apartamente për të aplikuar modelin shtëpi-familje. Sistemi i ngrohjes dhe ftohjes së ambienteve të dy godinave realizohet me panele diellor dhe kaldajë. Furnizimet me artikuj hotelerie ishte mjaft i mirë, i bollshëm dhe si pasojë e mirë menaxhimit si dhe e donacioneve të shumta, kushtet paraqiteshin shumë optimale për kujdesin e mirërritjen e këtyre fëmijëve. Problem i konstatuar është kuota ditore ushqimore, e cila është në zbatim të Udhëzimit Nr. 5, datë 1.8.2012 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesit shoqëror”. Avokati i Popullit nga shqyrtimi i kësaj çështje, ku ka rreth 5 vjet që nuk është kryer ideksi financiar i kuotës ushqimore shpreh shqetësimin për zgjidhjen e këtij problemi ku fëmijëve duhet t’ju garantohet ushqim i bollshëm dhe me vlera ushqimore.

### **Trajtimi i fëmijëve**

Fëmijët e sistemuar në këtë institucione janë për arsye të varfërisë dhe mungesës së mbështetjes së duhur nga familjet e tyre si rezultat i problemeve sociale (divorcit, vdekjes së njërit prind, ri-martësive etj) të cilat sjellin uljen e përgjegjësisë prindërore për kujdesin ndaj fëmijëve mos kthimin e fëmijëve në familjet biologjike si rezultat i mungesës së tipologjive të reja të shërbimeve për fuqizimin e familjes të cilat nuk ofrohen në këtë institucion si rezultat i të qenit institucion në nivel kombëtar dhe fëmijët janë të njëjstive bashkiake të ndryshme.

Nga kontrolli 3 dosjeve të përfituesëve, të institucionit u konstatua se ishin plotësuar të gjitha rubrikat dhe të firmosura nga përfituesit por nga kryqëzimi i informacionit, intervistave me fëmijët, konkludoi se fëmijët kishin informacion të përgjithshëm që kishin një dosje, por jo se për çfarë ju shërbenin fëmijëve të gjitha informacionet që mbaheshin në dosje dhe për çfarë do t’ju shërbenin gjatë qëndrimit të tyre në këtë shtëpi.

Shqetësimi i Avokatit të Popullit lidhur me këtë gjetje konsiston në plotësimin e dosjeve si një proces burokratik që duhet realizuar dhe jo si një element i rëndësishëm në garantimin e mirërritjes dhe zhvillimit normal të fëmijës duke parë interesin më të lartë të fëmijës, p.sh kthimin e tyre në familjen biologjike. Për fëmijët të cilët janë nga Bashkia Tiranë, rast pas rasti duhet të fillojë puna më njësitë për mbrojtjen e fëmijëve për të fuqizuar familjet biologjike nëpërmjet ofrimit të shërbimeve keshilluse për prindërim më të mirë, punësimi, strehim social etj për të mundësuar uljen e kohës së qëndrimit të fëmijëve në këtë institucion. Shërbimet që ju ofrohen fëmijëve duhet të jenë jo vetëm për fëmijët por për familjen, komunitetin etj.

Koha e qëndrimit të fëmijëve në këtë institucion varonte nga 13 vjet, në , 8 vjet , 6 vjetë, 5 vjet, 4 vjetë deri në 2 vjet. Me një veprim matematikor të thjeshtë mesatarisht 6 vjet. Ky fakt është shumë shqetësues për zhvillimin normal të fëmijës si pasojë e të cilit pengon ndjeshëm dhe dukshëm integritetin fizik, mendor të tyre. Në zbatim të pikës 10 të nenit

3 të ligjit Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” *“Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës* ky veprim është neglizhim i fëmijës nga shumë aktorë në nivel vendor dhe qëndror.

Mungesa e shumë programeve këshilluese për mbështetjen e prindërve që të kujdesen për fëmijët e tyre në komunitetin ky jetojnë, mungesa e shërbimeve ligjore të specializuara për mbrojtjen e fëmijës në organet e drejtësisë (gjykatat) janë disa nga faktorët që ndikojnë në qëndrimin afatgjatë të fëmijëve në institucionet e përkujdesit social.

Gjatë intervistave të realizuara me fëmijët grupi i inspektimit vërejtë me shqetësim masat e kufizuara të marra për promovimin e informacionit mbi shërbimet publike dhe jopublike që ofrohen jashtë institucionit (NJMF, kurset e formimit profesional, programet e nxitjes së punësimit, strehimi sociale etj). Informacioni i kufizuar pengon procesin e zhvillimit normal të fëmijës, integritetin e si dhe kufizon procesin e integritit para largimit nga institucioni Në institucion nuk kishte një ambiente të veçantë të pajisur me informacione të bollshme mbi shërbimet që ofrohen jashtë institucionit të cilat do ti ndihmonin në procesin e vendimarrjes (si p.sh fletë-palosje, broshura të ndryshme ose ëbsite të cilat të përmbanin këtë informacion të domosdoshëm për procesin e integritit) para largimit nga institucioni.

Rregullorja e Qendrës duhet të ketë më mirë të përcaktuar punën e fundjavës me fëmijët të drejtat dhe detyrimet e tyre të cilat rrjedhin nga Konvetat e miratuara nga shteti shqiptar të cilat duhet të jenë në forma të ndryshme p.sh broshura, fletepalosje etj në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme nga fëmijët.

Gjithashtu u konstatua se edhe pjesëmarrja e fëmijëve në vendimarrje (gjatë të gjitha fazave të plotësimit të dosjeve, jetesës në institucion etj) mbetet e kufizuar, ku në përgjithësi përjashtohen fëmijë nga e drejta për t’u përfshirë në vendimarrje e cila pengon procesin e krijimit të jetesës së pavaruar. Respektimi i mendimeve të fëmijës dhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje është një e drejtë e parashikuar në nenin 12 të Konvetës për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Shqetësimet e parashtruara në raport lidhen direkt ose indirekt me procesin e de-institucionalizimit dhe decentralizimit. Procesi i deinstitutionalizimit parashikuar në Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2015-2020 e cila synon reformimin e Programit të Mbrojtjes Sociale duke treguar kujdes të veçantë për fëmijët jetimë social dhe biologjikë dhe ofrimin e shërbimeve të integruara ka parashikuar hartimin e planit të veprimit të de-institucionalizimit. Avokati i Popullit është i shqetësuar për mos miratimin e planit të veprimit të de-institucionalizimit për vazhdimësinë dhe përfundimin më sukses të këtij procesi dhe mos kalimin e këtij institucioni nën varësinë administrative të Bashkisë Tiranë. Në vlerësimin e realizimit të procesit të deinstitutionalizimit i cili është një proces i gjatë në kohë ku duhet të shoqërohet me burime njerezore dhe financiare Avokati i Popullit rekomandon që cdo veprimi i ndërmarrë duhet të jetë në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

Avokati i Popullit vlerëson punën e realizuar nga institucionet përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të përkujdesit social rezidenciale për fëmijët në nevojë lidhur me të gjitha masat e ndërmarrja për krijimin e kushteve sa më të mira për të garantuar zhvillimin normal të fëmijës. Duke falenderuar punën e nisur për transformimin e Shtëpisë së fëmijës

“Zyber Hallulli” nga shërbim rezidencial në modelin shtëpi-familje për rritjen e cilësisë së shërbimeve në këtë shtëpi Avokati i Popullit kërkon zbatimin e rekomandimeve,

Në zbatim të nenit 21 të ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

### REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për të përshpejtuar miratimin e draft-planit të veprimit të de-institucionalizimit.
2. Marrjen e masave për indeksimin financiar të kuotës ushqimore për fëmijët përfitues të shërbimeve sociale.
3. Nisjen e procesit të transferimit të Shtëpisë së fëmijës “Zyber Hallulli” nën varësinë administrative të Bashkisë Tiranë.
4. Informimin e fëmijëve me të gjitha alternativat e tjera të shërbimet publike dhe jo-publike që ofrohen jashtë institucionit për të garantuar përfshirjen e tyre në vendim marrje.
5. Marrjen e të gjitha masave e nevojshme për të ulur kohëqëndrimin e fëmijëve në institucione, duke rishikuar praktikën e vendosjes në to dhe ofrimin e shërbimeve të tipologjive të ndryshme nga Bashkitë, sikurse kërkohet në nenin 25 të Konventës.
6. Përforsimin e përpjekjeve nga stafi i “Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli” me synim që fëmijët të kenë të drejtë të shprehin lirshëm mendimet e tyre në të gjitha çështjet që lidhen me ta, në hartimin e planit të përkujdesjes, planit të së ardhmes, jetesës në shtëpi etj.
7. Marrjen e masave për përfshirjen në rregulloren e institucionit, profilizimin e institucionit konkretisht të Shtëpisë së Fëmijës “Zyber Hallulli”, kalendarin e trajnimeve për stafin.
8. Marrjen e masave me qëllim që të sigurojë se parimi i interesit më të lartë të fëmijës përfshihet në mënyrën e duhur dhe aplikohet gjerësisht në të gjitha procedurat administrative (degjetat me fëmijët për indeksimin e kuotës ushqimore, ndryshimet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të Shtëpisë së Fëmijës etj) si dhe programet dhe projektet e ndryshme për fëmijët dhe që ndikojnë tek ta;

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”.Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve.

**K O M I S I O N E R I**

**Ermir KAPEDANI**

